



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT NË FUSHËN E SIGURISË USHQIMORE,
VETERINARISË, MBROJTJES SË BIMËVE DHE PESHKIMIT

Nr _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2025

ÇERTIFIKATË RIREGJISTRIMI

Nr. 497/1, date 23.10.2025.

Bazuar në:

- Ligjin nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar;
 - Vendimin nr. 335, datë 6.6.2018, “Për miratimin e rregullave për regjistrimin, të procedurës dhe kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar;
- Komisioni i regjistrimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve (KRPMB),

VENDOSI:

Të bëjë **riregjistrimin** për shitjen dhe përdorimin në territorin e Republikës së Shqipërisë të **Fungicidit** me emrin tregtar:

MIKAL PREMIUM F

me kushtet e mëposhtëme (si dhe gjithë specifikimet e bëra në dosjen e regjistrimit):

- 1. Aplikanti:** Bayer d.o.o. **Adresa:** Ljubljana; Slloveni.
- 2. Prodhuesi:** Bayer AG. **Adresa:** Leverkusen, Gjermani. *Linjat e fabrikimit:*
- 3. Të dhënat teknike të PMB-së:**
 - a. Lënda vepruese e paster (gr/kg):** Fosetyl aluminium 500+folpet 250+iprovalicarb 40. *Kufijtë min/max: Fosetyl aluminium 475-525+folpet 235-265+iprovalicarb 36-44.*
 - b. Formulimi:** *Granula te dispergueshme ne uje (WG).*
 - c. Pamja:** *Granula me ngjyre kafe te lehte.*
 - d. Përdorimi:** *Sipas etiketës bashkëlidhur.*

Kjo certifikatë është e vlefshme deri më: **31.10.2027.**

KRYETARI KOMISIONIT

Zv/ministër Arian Jaupllari

MIKAL PREMIUM F

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



GHS 07



GHS08



GHS09

Fjalë sinjalizuese: Paralajmërim.

Te perdoret vetem nga perdorues profesioniste

“Lexo fletudhëzuesin para përdorimit”

-Fosetyl-Al ka veprim shume te mire sistemik dhe efekt te zgjatur. Vepron duke rritur ne bime perqendrimin e substancave mbrojtese natyrore si dhe duke demtuar direkt patogjenet. Ne bime leviz ne te dy drejtimet dhe mbron bimet nga preket e vrugut ne kerrell e rrenje edhe thjesht me trajtimet gjethore. Eshte vecanerisht efektiv ndaj vrugjeve te gjinive *Phytophthora*, *Pythium*, *Bremia*, *Peronospora*, *Plasmopara*. Kontrollon gjithashtu patogjene te gjinive *Phomopsis*, *Alternaria*, *Penicillium*, *Venturia*, etj, si dhe disa semundje bakteriale si *Erwinia amylovora*.

Megjithse ka efekt kurativ, efekti me i mire eshte kur trajtimet kryhen para shfaqjes se infeksionit.

-Folpeti ka veprim kontakti dhe spekter shume te gjere veprimi.

-Iprovalicarb eshte lende aktive e re me veprim sistemik, derivat i acideve amino natyrale. Ka veprim parambrojtes, kurues dhe çrrenjoses, shume efektiv sidomos ndaj *Oomyceteve*. Kontrollin e patogjeneve e realizon ne menyra krejt te ndryshme nga ato te preparateve te tjere, qe perdoren per kontrollin e ketyre semundjeve.

Lendet vepruese e paster (gr/kg): *Fosetyl aluminium 500+folpet 250+iprovalicarb 40. Kufijtë min/max:*

Fosetyl aluminium 475-525+folpet 235-265+iprovalicarb 36-44.

Formulimi: *Granula te dispergueshme ne uje (WG).*

Ngjyra: *Kafe e lehte.*

Deklaratat e rrezikut:

H317-Shkakton acarim alergjik të lekures.

H319-Shkakton acarim serioz të syve.

H351-Dyshohet se shkakton kancer.

EUH401-Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, ndiqni udhëzimet për përdorim.

EUH208-Përmban folpet. Mund të shkaktojë reaksion alergjik.

Deklarata paraprake:

P202-Mos e perdorni derisa të keni lexuar dhe kuptuar të gjitha masat paraprake të sigurisë.

P270-Mos hani, pini ose pini duhan kur përdorni produktin.

P280-Vishni doreza/veshje mbrojtëse/mbrojtëse për sytë/mbrojtëse për fytyrën.

P305+P351+P338-Nëse ju bie në sy: Lajini me ujë të bollshëm për disa minuta. Hiqni lentet e kontaktit nëse keni dhe do jetë më e lehtë.

P308+P311-NËSE ekspozoheni ose shqetësoheni: Telefononi një QENDËR HELMI/mjek/mjekun.

P391-Mblidhni derdhjen.

P501-Hidhni përmbajtjen/enën në përputhje me rregulloret lokale.

Udhëzime per ndihmen e pare dhe keshilla per mjekun:

- Këshilla të përgjithshme: Largohuni nga zona e rrezikshme. Vendoseni dhe transportojeni te aksidentuarin në një pozicion të qëndrueshëm (të shtrirë anash). Hiqni menjëherë rrobat e kontaminuara dhe hidhni në mënyrë të sigurt.
- Thithja: Zhvendoseni në ajër të pastër. Mbajeni pacientin ngrohtë dhe në qetësi. Telefononi menjëherë një mjek ose një qendër kontrolli helmimesh.
- Kontakti me lëkurën: Lani mirë me shumë sapun dhe ujë, nëse është e mundur me polietilenglikol 400, më pas shpëlajeni me ujë. Nëse simptomat vazhdojnë, telefononi një mjek.

- Kontakti me sy: Shpëlajeni menjëherë me shumë ujë, edhe nën qepalla, për të paktën 15 minuta. Hiqni lentet e kontaktit, nëse i keni, pas 5 minutave të para, pastaj vazhdoni shpëlarjen e syve. Kërkoni ndihmë mjekësore nëse shfaqet acarim dhe vazhdon.
- Nxireni te demtuarin ne ajer te paster.
- Gëlltitje: Shpëlani gojën. MOS nxisni të vjella. Telefononi menjëherë një mjek ose një qendër kontrolli helmimesh dhe tregojini mjekut etiketen.
- Nuk njihet antidot specifik. Mjekimi sipas simptomave.

Perdorimi:

Perdoret ne vresht, per kontrollin e vrugut (*Plasmopara viticola*), me 3 kg/ha. Kontrollon gjithashtu kalbezimin gri dhe nekrozen. Aplikohen deri 3 trajtime/sezon, me interval 12-14 dite, ne vartesi nga infeksioni. Efektiviteti me i mire arrihet kur behen trajtime parambrojtese, megjithse ka edhe efekt kurativ. Perdoret nga stadi i 5 gjetheve, deri ne fillim te pjekjes.

Verejtje per perdorimin:

Trajtimet kryhen kur ka rrezik infeksioni ose duke u bazuar ne te dhenat qe jep prognoza.

Perdoren volume te medha tresire sperkatese, per te siguruar lagie te mire te mases gjethore.

Perzihet me fungicidet dhe insekticidet e Bayerit qe perdoren ne te njejen kulture. Nuk perzihet me produktet pleheruese gjethore, formulimet e bakrit, me koncentratet vajore, squfur.

Fitotoksiciteti:

Ne dozat dhe bimet e rekomanduara nuk shfaq shenja fitotoksiciteti.

Ndikimi ne ekosistem:

H400- Shumë helmues për jetën ujore.

H410: Shumë helmues dhe me efekte afatgjate ndaj organizmave ujore. Enet e perdorura per kete produkt i zbrazni plotësisht dhe nuk duhet ti shpërndani në mjedis. Ambalazhet bosh nuk duhet te ripërdoren. Mos ndotni ujin me produktin ose enën e tij. Shmangni kontaminimin përmes sistemeve të kullimit te ujit nga feramat dhe rrugët. Per mbrojtjen e gjallesave ujore mos trajtoni ne parcelat te cilat jane me pak se 20 m larg siperfaqeve ujore.

Karenca:

42 dite per rrushin per vere.

Magazinimi:

Ruajeni në enën origjinale. Mbajini enët të mbyllura mirë në një vend të thatë, të freskët dhe të ajrosur mirë. Ruajeni në një vend të arritshëm vetëm nga persona të autorizuar. Mbajeni larg rrezeve të diellit. Ne temperatura te larta, mund te vetenxehet. Mbajeni larg ushqimit, pijeve dhe ushqimeve për kafshë.

Nr dhe data e regjistrimit: 497/1, date 23.10.2025.

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: 60 gr, 600 gr, 1 kg.

Bar kodi perkates: ;

Data e prodhimit: ;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkeseva të përcaktuara): 3 vjet;

Numri i partise se mallit (serise) ose shenja te tjera identifikuese: ;

Tipi i ambalazhit baze: Material i papershkueshem nga lageshtia (LDPE-polietileni me dendësi të ulët ose Fletë polipropileni (PP)).

Emri dhe adresa e fabrikuesit te PMB-se: Bayer AG. **Adresa:** Leverkusen, Gjermani.

Emri dhe adresa e kerkuesit: Bayer d.o.o. **Adresa:** Ljubljana; Slloveni.

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhimi kryhet ne R Sh):